# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 71

**Tiranë – E premte, 14 maj 2021**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 41/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar..... | 6969 |
| Ligj nr. 42/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"..... | 6975 |
| Ligj nr. 43/2021, datë 23.3.2021 | Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar..... | 6978 |
| Ligj nr. 44/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar..... | 6980 |
| Ligj nr. 45/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar... | 6985 |
| Ligj nr. 46/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"..... | 6986 |
| Ligj nr. 47/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"..... | 6989 |
| Ligj nr. 48/2021, datë 23.3.2021 | Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore"..... | 6991 |
| Ligj nr. 49/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar..... | 6992 |
| Ligj nr. 50/2021, datë 23.3.2021 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. | 6994 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 34/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 017, datë 12.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 46/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, 'Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"'..... | 7001 |
| Vendim i Kuvendit nr. 35/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 035, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 43/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar"'..... | 7001 |
| Vendim i Kuvendit nr. 36/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 036, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 47/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, 'Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"'..... | 7001 |
| Vendim i Kuvendit nr. 37/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 037, datë 19.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 48/2021, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019, 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore"'..... | 7002 |
| Vendim i Kuvendit nr. 38/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 033, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 49/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, 'Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', të ndryshuar"'..... | 7002 |
| Vendim i Kuvendit nr. 39/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 034, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 42/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"'..... | 7002 |
| Vendim i Kuvendit nr. 40/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 031, datë 15.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 41/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar"'..... | 7003 |
| Vendim i Kuvendit nr. 41/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 032, datë 15.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 44/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar"'..... | 7003 |
| Vendim i Kuvendit nr. 42/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 023, datë 14.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 45/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, 'Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese', të ndryshuar"'..... | 7003 |
| Vendim i Kuvendit nr. 43/2021, datë 7.5.2021 | Për rrëzimin e dekretit nr. 13 038, datë 19.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 50/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"'..... | 7004 |
| Vendim i Kuvendit nr. 44/2021, datë 7.5.2021 | Për miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut "Për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës"..... | 7004 |
| Vendim i Kuvendit nr. 46/2021, datë 7.5.2021 | Për zgjedhjen e zonjës Milena Selimi anëtare të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... | 7005 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 47/2021, datë 7.5.2021 | Për zgjedhjen e zotit Thanas Goga anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... | 7005 |
| Vendim i Kuvendit nr. 48/2021, datë 7.5.2021 | Për zgjedhjen e zotit Gëzim Podgorica anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... | 7005 |
| Vendim i Kuvendit nr. 49/2021, datë 7.5.2021 | Për zgjedhjen e zotit Engjëll Ndocaj anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... | 7006 |

**LIGJ**
**Nr. 41/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, datë 21.3.1995, "KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 14 pika 4 ndryshohet si më poshtë:
"4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij Kodi shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm.".

Neni 2

Neni 14/a ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14/a
**Gjykata e Lartë dhe përbërja**

Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.".

Neni 3

Në nenin 15, pika 2, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
"Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.".

Neni 4

Në nenin 21 pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.".

Neni 5

Në nenin 22, pika 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
"Kundër tij mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.".

Neni 6

Pas nenit 22 shtohet neni 22/a me këtë përmbajtje:

"Neni 22/a
**Sanksione për kërkesën e deklaruar të papranueshme**

Vendimi që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit ose që nuk pranon përjashtimin e gjyqtarit përmban shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50 000 lekë, në ngarkim të palës që, duke abuzuar, ka parashtruar një kërkesë të padrejtë.".

Neni 7

Në nenin 75/a shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:
"a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;".

Neni 8

Në nenin 249, pika 1, pas togfjalëshit "për caktimin e masës së sigurimit" shtohet togfjalëshi "mospranimin ose rrëzimin e saj".

Neni 9

Në nenin 264, pika 1, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

"Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.".

Neni 10

Në nenin 291 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"Ankimi u njoftohet menjëherë prokurorit dhe palëve të tjera.".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit. Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit, si dhe ka të drejtë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit.".

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.".

Neni 11

Në nenin 318 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

"2. Kur nuk e pranon kërkesën, prokurori merr vendim të arsyetuar dhe njofton personin viktimë, i cili mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit. Ankimi i njoftohet menjëherë prokurorit.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës. Prokurori, jo më vonë se 2 ditë nga njoftimi i ankimit, mund të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit dhe të depozitojë prova në mbështetje të tyre.".

Neni 12

Në nenin 320, pika 1, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas togfjalëshit "gjykata merr vendim" shtohet togfjalëshi "në dhomë këshillimi".

2. Në fjalinë e tretë pas togfjalëshit "shqyrton ankesën" shtohet togfjalëshi "në dhomë këshillimi".

Neni 13

Në nenin 324, pika 3, pas togfjalëshit "Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve" shtohet togfjalëshi "jepet i arsyetuar dhe".

Neni 14

Në nenin 325 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Ankimi u njoftohet menjëherë palëve të tjera.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1 Brenda 5 ditëve nga njoftimi i ankimit, prokurori, i pandehuri ose viktima sipas rastit, mund të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit, si dhe të depozitojnë prova në mbështetje të tyre.".

3. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

"2. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës.".

4. Në pikën 4 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës.".

Neni 15

Në nenin 332 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjykim shqyrtohet në seancë paraprake nga gjyqtari i vetëm. Kërkesat për dërgimin në gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i seancës paraprake.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim, gjyqtari i seancës paraprake cakton datën e zhvillimit të saj. Në rastet kur i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, zbatohen rregullat e nenit 49 të këtij Kodi.".

Neni 16

Në nenin 332/a pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140-142 të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancën paraprake dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, gjykata vendos sipas pikave 1, 2, 3 ose 4 të nenit 352 të këtij Kodi.".

Neni 17

Në nenin 332/dh, në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit;".

2. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t'u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë.

Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit.".

3. Pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj.".

Neni 18

Në nenin 384 pika 3 shfuqizohet.

Neni 19

Në nenin 386, pika 2, në fjalinë e parë togfjalëshi "që nuk kanë qenë të pranishme në shpalljen e tij" shfuqizohet.

Neni 20

Në nenin 406/dh, pika 1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kur marrëveshja paraqitet në seancën paraprake, gjykata vendos sipas parashikimeve të nenit 332/dh, pika 1, shkronja "b", të këtij Kodi.".

Neni 21

Në nenin 415 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë, togfjalëshi "shpalljes ose" shfuqizohet.

2. Në pikën 2 togfjalëshi "arsye të tjera që lidhen me ankimin" zëvendësohet me togfjalëshin "parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim".

Neni 22

Në nenin 417, pika 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në rastet e rekursit, vendimi mund të pezullohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vetëm në rastet e parashikuara nga pika 1 e nenit 476 të këtij Kodi.".

Neni 23

Neni 426 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 426
**Shqyrtimi i çështjes në apel**

1. Gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short.

2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë.

3. Gjyqtari relator i çështjes urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të padituri civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë.

4. Urdhri i thirrjes është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk është identifikuar në mënyrë të sigurt ose kur nuk janë saktësuar vendi, dita dhe ora e paraqitjes.".

Neni 24

Në nenin 426/a bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshon si vijon: "Seanca gjyqësore".

2. Në pikën 1 togfjalëshi "Përpara se të fillojë shqyrtimin gjyqësor," zëvendësohet me fjalën "Fillimisht".

Neni 25

Në nenin 427 bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 1 togfjalëshi "ose plotësimin e tij," shfuqizohet.

Neni 26

Pas nenit 427 shtohet neni 427/a me këtë përmbajtje:

"Neni 427/a
**Gjykimi në apel në dhomë këshillimi**

1. Në rastet kur ky Kod parashikon gjykimin në apel në dhomë këshillimi, gjykimi bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh.

2. Gjyqtari relator urdhëron njoftimin e palëve sipas nenit 426 të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë që deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi, të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në apel dhe apelin kundërshtues.

3. Për çështjen që shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, relatori përgatit paraprakisht dhe u shpërndan anëtarëve një relacion të përmbledhur të dosjes gjyqësore dhe shkaqeve të ngritura në ankim.

4. Shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi vijon nëse njoftimet e palëve janë të rregullta.

5. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.".

Neni 27

Në nenin 434 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Në rastet kur Gjykata e Lartë kryesisht vë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Njoftimi në këto raste kryhet sipas rregullave të përgjithshme.".

Neni 28

Pas nenit 434 shtohet neni 434/a me këtë përmbajtje:

"Neni 434/a
**Përmbajtja e rekursit**

1. Rekursi duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse;

b) vendimin që kundërshtohet;

c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;

ç) shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 432 të këtij Kodi;

d) prokurën e avokatit në rastet kur rekursi paraqitet nga i pandehuri ose palët private.

2. Rekursi mund të paraqitet në përputhje me formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Gjykatës së Lartë.".

Neni 29

Në nenin 435 pika 1 ndryshon si më poshtë:

"Rekursi paraqitet me shkrim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit. Afati për paraqitjen e rekursit kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë është 20 ditë. Rekursi shqyrtohet nga Gjykata e Lartë jo më vonë se dy muaj nga momenti i regjistrimit të tij në sekretarinë gjyqësore.".

Neni 30

Pas nenit 435 shtohet neni 435/a me këtë përmbajtje:

"Neni 435/a
**Kundërrekursi**

1. Pala kundër së cilës është paraqitur rekurs mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër. Në rastin kur rekursi është paraqitur kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, afati për paraqitjen e kundërrekursit është 10 ditë.

2. Kundërrekursi i njoftohet atij që ka bërë rekursin brenda 20 ditëve nga komunikimi i rekursit.

3. Për kundërrekursin zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 423 të këtij Kodi.".

Neni 31

Në nenin 436 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj.".

Neni 32

Pas nenit 436 shtohet neni 436/a me këtë përmbajtje:

"Neni 436/a
**Shqyrtimi i çështjes**

1. Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

2. Gjyqtari relator paraqet relacionin duke pasqyruar në të, veç të tjerave, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.".

Neni 33

Në nenin 437 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:

a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të nenit 432 të këtij Kodi.".

Neni 34

Neni 438 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 438
**Njësimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore**

1. Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Penal ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Penal me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, në të cilën marrin pjesë trupa gjyqësore

që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të kolegjit të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.”.

Neni 35

Pas nenit 438 shtohet neni 438/a me këtë përmbajtje:

“Neni 438/a
**Procedimet paragjykimore**

1. Nëse Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendosin t’i drejtohen Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, vendosin pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimi i pezullimit zgjat deri në marrjen e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Vendimi i gjykatës ndërkombëtare u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.”.

Neni 36

Neni 441 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 441
**Vendimet e Gjykatës së Lartë**

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 432 i këtij Kodi;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit;

d) prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;

dh) ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit

procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.".

Neni 37

Në nenin 491 shkronja "c" shfuqizohet.

Neni 38
**Dispozitë kalimtare**

1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

3. Çështjet që janë në kompetencën e Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimit të nenit 75/a përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që janë regjistruar përpara datës 1 qershor 2021 hetohen dhe gjykohen nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pavarësisht ndryshimit të kompetencës lëndore, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Neni 39

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç sa është parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Neni 7 i këtij ligji hyn në fuqi më 1 qershor 2021.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 42/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2016, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) "Këshilltar ligjor" është këshilltari që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.".

Neni 2

Në nenin 15, pika 1, pas togfjalëshit "krimit të organizuar" shtohet fjala ",terrorizmit".

Neni 3

Në nenin 57, pika 1, shkronja "a", pas termit "kancelari" shtohet togfjalëshi ", këshilltari ligjor".

Neni 4

Në nenin 65, pika 1, togfjalëshi "prokurorët e komanduar, sipas nenit 69 të këtij ligji" zëvendësohet me togfjalëshin "Njësia e Shërbimit Ligjor".

Neni 5

Neni 69 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 69
**Njësia e Shërbimit Ligjor**

1. Pranë Prokurorisë së Përgjithshme funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor.

2. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Prokurorisë së Përgjithshme duke përfshirë:

a) analizimin, studimin e ankimeve dhe dosjeve penale;

b) përgatitjen e relacioneve për çështjet objekt gjykimi përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;

c) kryerjen e kërkimeve ligjore;

ç) përgatitjen e projektakteve;

d) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjeve që i ngarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili cakton këshilltarin ligjor pranë një prokurori ose drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.

4. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

5. Prokurorët e komanduar caktohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në Prokurorinë e Përgjithshme sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6. Vlerësimi i punës së prokurorëve të komanduar kryhet nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në mendimin e dhënë nga prokurori pranë të cilit është komanduar.

7. Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj. Këshilltari ligjor jomagjistrat përfiton pagë të barabartë me "pagën bruto fillestare" të prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë, pa përfitimet e tjera financiare, sipas referimeve të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

8. Këshilltari ligjor jomagjistrat duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë diplomuar në drejtësi në nivelin "Master shkencor", të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

b) përvojë profesionale jo më pak se 5 vjet si nëpunës i lartë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare;

c) njohuri në jurisprudencën e gjykatave vendase dhe atyre ndërkombëtare;

ç) njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të vendeve të Bashkimit Europian;

d) aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor;

dh) të mos ketë masa disiplinore në fuqi në pozicionet e mëparshme;

9. Këshilltari ligjor dhe ndihmësmagjistrati u nënshtrohen rregullave të papajtueshmërisë, kufizimeve në detyrë dhe konfliktit të interesave ashtu si magjistrati.

10. Prokurori i Përgjithshëm përfshin në projektbuxhet propozimin për numrin e këshilltarëve ligjorë.

11. Prokurori i Përgjithshëm miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 6

Në nenin 70, pika 1, pas shkronjës "a" shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:

"a/1) këshilltari ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme;".

Neni 7

Në nenin 72 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas togfjalëshit "kryen formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarëve ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme" dhe pas togfjalëshit "për një periudhë prej të paktën tre muajsh" shtohet togfjalëshi "dhe për këshilltarët ligjorë për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh".

2. Në pikën 4, pas togfjalëshit "për kancelarët" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarët ligjorë".

Neni 8

Në nenin 73 bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e dispozitës, pas togfjalëshit "për kancelar" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarë ligjorë".

2. Në pikën 1 pas togfjalëshit "të paktën çdo tre vjet" shtohet togfjalëshi "dhe për këshilltarët ligjorë".

3. Në pikën 2 pas togfjalëshit "numrin e vendeve të lira" shtohet togfjalëshi "për këshilltarët ligjorë për vitin e ardhshëm".

Neni 9

Në nenin 75, pika 1, pas togfjalëshit "për kancelarët" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarët ligjorë".

Neni 10

Në nenin 76 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Për pozicionin e këshilltarit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.".

Neni 11

Në nenin 78, pika 2, pas togfjalëshit "renditjen e kancelarëve" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarë ligjorë".

Neni 12

Në nenin 79 bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e dispozitës, pas togfjalëshit "kancelarit" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarit ligjor".

2. Në pikën 1 pas fjalës "kancelarit" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarit ligjor".

3. Në pikën 2 pas togfjalëshit "për kancelar" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltar ligjor" dhe pas togfjalëshit "për pozicionin e kancelarit" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarit ligjor".

4. Në pikën 3 pas togfjalëshit "për kancelar" shtohet togfjalëshi "dhe për këshilltar ligjor".

Neni 13

Në nenin 84 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 pas togfjalëshit "për emërimin e kancelarëve" shtohet togfjalëshi ",këshilltarëve ligjorë jomagjistratë".

2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtjen si më poshtë:

"5/1. Këshilltari ligjor kandidat merr një shpërblim të barabartë me 50 për qind të pagës fillestare si këshilltar ligjor gjatë kursit të formimit fillestar.".

3. Në pikën 6, fjalia e parë, pas fjalës "Kancelarët" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarët ligjorë" dhe në fjalinë e dytë pas togfjalëshit "mandati i kancelarit" shtohet togfjalëshi "ose këshilltarit ligjor".

4. Pika 8 shfuqizohet.

Neni 14

Në nenin 86, pika 3, fjalia e tretë, pas termit "kancelarit" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarit ligjor".

Neni 15

Në nenin 87, pika 2, pas togfjalëshit "për kancelarin" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarin ligjor".

Neni 16

Në nenin 89 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja "a", pas togfjalëshit "përveç kancelarit" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarit ligjor".

2. Në pikën 1, shkronja "b", pas togfjalëshit "për kancelarin" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarin ligjor".

3. Në pikën 2, shkronja "a", pas togfjalëshit "për kancelarin" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarin ligjor".

Neni 17

Në nenin 100, pika 3, pas togfjalëshit "për kancelarin" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarin ligjor".

Neni 18

Pas nenit 108 shtohet neni 108/a me këtë përmbajtje:

"Neni 108/a

1. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e nevojshëm për hetimin e veprave penale që përfshihen në juridiksionin e tyre sipas nenit 148 të Kushtetutës.

2. Niveli i aksesimit për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, për çdo bazë të dhënash shtetërore, caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon bazat e të dhënave shtetërore, duke garantuar që në çdo rast ky nivel të jetë vetëm për përmbushjen e nevojës për informacion që kërkohet nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Prokurorët mund të aksesojnë një bazë të dhënash shtetërore vetëm në rastet kur informacioni që ruhet në atë bazë të dhënash shtetërore është i nevojshëm për të hetuar një vepër penale.

3. Aksesi në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, sipas këtij neni, u nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe institucionet shtetërore që administrojnë bazat e të dhënave shtetërore marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Parashikimet e bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që ruajnë dhe/ose përpunojnë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror". Aksesi i prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror.".

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

## LIGJ
## Nr. 43/2021

## PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 244 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 244
**Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.".

Neni 2

Neni 245/1 ndryshohet si më poshtë:

Neni 245/1
**Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, personit që premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

Neni 3

Neni 258 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 258
**Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike**

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.".

Neni 4

Neni 259 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 259
**Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike**

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 qershor 2021.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 44/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në paragrafin e katërt fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod.".

2. Në paragrafin e fundit pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

"Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.".

Neni 2

Në nenin 59 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kur gjykata vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, ndërsa kur vendos që çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, kundër vendimit lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.".

Neni 3

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

"Kundër vendimit të gjykatës mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.".

Neni 4

Neni 63 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 64 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata ka të drejtë t'ia parashtrojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.".

2. Pas paragrafit të dytë shtohen paragrafët e tretë dhe të katërt me këtë përmbajtje:

"Gjykata e Lartë shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga momenti i depozitimit të parashtresës.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente.".

Neni 6

Në nenin 75 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e trupit gjykues të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.".

2. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

"Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një gjyqtar tjetër i kësaj

gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.".

Neni 7

Në nenin 162/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 togfjalëshi "deri në 150 000 lekë" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Në rast se vlera e padisë është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe vlera e kundërpadisë tejkalon njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykimi zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme për gjykimin e zakonshëm.".

Neni 8

Në nenin 236/a togfjalëshi "deri në 150 000 lekë" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi".

Neni 9

Në nenin 285/a, pika 1, togfjalëshi "deri në 150 000 lekë" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi".

Neni 10

Në nenin 310, paragrafi II, pika 3, togfjalëshi "deri në 150 000 lekë" zëvendësohet me togfjalëshin "deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi".

Neni 11

Në nenin 443, paragrafi i katërt, pas togfjalëshit "Afati i ankimeve" shtohet togfjalëshi "dhe rekurseve".

Neni 12

Në nenin 460 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 5, fjalia e parë, pas togfjalëshit "orën e gjykimit" shtohet togfjalëshi "si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen".

2. Pas fjalisë së fundit të pikës 5 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk është njoftuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë pikë, palët mund të kërkojnë shtyrjen e gjykimit, përveç rasteve kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve".

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1. Palët kanë të drejtë që deri në 5 ditë para shqyrtimit të çështjes të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim."

Neni 13

Në nenin 465/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 togfjalëshi "Kryetari i trupit gjykues" zëvendësohet me fjalën "Relatori".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Gjykata në dhomë këshillimi vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm:

a) për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar fakte ose prova të reja, sipas nenit 465 të këtij Kodi; ose

b) kur vë në diskutim çështje të faktit ose të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.".

Neni 14

Në nenin 466 pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes lejohet rekurs i veçantë.".

Neni 15

Në nenin 467 pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, lejohet rekurs i veçantë.".

Neni 16

Në nenin 469 paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 17

Në nenin 470 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 pas togfjalëshit "në gjykatën e apelit" shtohet togfjalëshi "ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë".

2. Në pikën 3 pas fjalës "Ankimet" shtohen fjalët "ose rekurset".

Neni 18

Pas nenit 471 shtohet neni 471/a me këtë përmbajtje:

"Neni 471/a
**Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve jopërfundimtare**

Ankimet dhe rekurset e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.".

Neni 19

Në nenin 473/a pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Njoftimi në këto raste kryhet sipas rregullave të përgjithshme.".

Neni 20

Neni 474 ndryshohet si më poshtë:

"Rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë nënshkruhen nga avokati që e përfaqëson palën dhe, nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.".

Neni 21

Në nenin 475 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 472 të këtij Kodi;".

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Rekursi mund të paraqitet sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.".

Neni 22

Neni 476 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 476
**Depozitimi i rekursit**

1. Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit që u është bërë palëve.

2. Së bashku me rekursin duhet të depozitohet:

a) kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe, kur është rasti, edhe e njoftimit kur ky është bërë;

b) prokura e posaçme;

c) aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi në aq kopje sa janë palët.

3. Kur rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk është nënshkruar sipas nenit 474 ose nuk është paraqitur në përputhje me paragrafin e parë të nenit 475 të këtij Kodi, relatori që ka dhënë vendimin ose gjyqtari i vetëm njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit brenda 5 ditëve. Në këtë rast shqyrtimi i rekursit bëhet në dhomë këshillimi.

4. Kur ankuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat brenda afatit, rekursi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet palës së bashku me aktet e tjera të paraqitura prej tij. Kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e rekursit mund të bëhet rekurs i veçantë.

5. Kur të metat e rekursit janë plotësuar në afatin e caktuar, konsiderohet i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë.

6. Sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, pas shqyrtimit nga gjyqtari nëse

rekursi është plotësuar në afat, përcjell dosjen së bashku me dokumentet në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.

7. Kur të metat e rekursit nuk janë konstatuar nga gjykata më e ulët, relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë me vendim njofton palën për të plotësuar të metat brenda 5 ditëve. Kur të metat e rekursit nuk plotësohen brenda afatit, relatori, në dhomë këshillimi, vendos kthimin e rekursit. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.".

Neni 23

Neni 481 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 481
**Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore**

1. Kolegji Civil, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Civil ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosin ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë, që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim, cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, që në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Neni 24

Neni 482 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 482
**Shqyrtimi i çështjes**

1. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

2. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj.

3. Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.

4. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

5. Gjyqtari relator paraqet relacionin duke pasqyruar në të, veç të tjerave, arsyet e përshpejtimit të çështjes, nëse ka, përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

6. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.".

Neni 25

Pas nenit 482 shtohet neni 482/a me këtë përmbajtje:

"Neni 482/a
**Kalimi i çështjes në seancë gjyqësore**

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:

a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas shkronjave "b" dhe "c" të nenit 472, si dhe paragrafit të dytë të nenit 473/a të këtij Kodi.

2. Vendimi i mësipërm, si dhe data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës.".

Neni 26

Pas nenit 483 shtohet neni 483/a me këtë përmbajtje:

"Neni 483/a
**Procedimet paragjykimore**

1. Nëse Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendosin t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ata marrin vendim për pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimi i pezullimit zgjat deri në dhënien e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Palëve u njoftohet vendimi i gjykatës ndërkombëtare së bashku me datën e seancës së radhës në Gjykatën e Lartë.".

Neni 27

Neni 485 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 485
**Vendimet e Gjykatës së Lartë**

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij Kodi;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;

d) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;

dh) ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin

ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.".

Neni 28

Pas nenit 485/a shtohet neni 485/b me këtë përmbajtje:

"Neni 485/b
**Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë**

Sekretaria gjyqësore njofton vendimet e Gjykatës së Lartë sipas nenit 316 të këtij Kodi.".

Neni 29

Neni 490 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 490
**Heqja dorë nga rekursi**

1. Pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa Kolegji Civil apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë tërhequr për vendim. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj, e pajisur me prokurë për këtë qëllim.

2. Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve. Kur hiqet dorë nga rekursi dhe në gjykim kanë marrë pjesë të gjitha palët ose përfaqësuesit e tyre, nuk ka vend për shpallje të veçantë të vendimit të mospranimit të rekursit, por palëve u vihet në dispozicion vendimi.".

Neni 30

Në nenin 493 pas paragrafit të parë shtohen paragrafët e dytë dhe të tretë me këtë përmbajtje:

"Gjykata e Lartë, kur dërgon çështjen për rigjykim, në vendim përcakton se cila pjesë e vendimit ose gjykimit të faktit prishet dhe për cilën pjesë të mosmarrëveshjes duhet të zhvillohet rigjykimi.

Rigjykimi i çështjes pas prishjes së vendimit kufizohet vetëm në shkaqet e prishjes së vendimit. Pjesët e pacenuara të vendimit apo gjykimit nga gjykata më e lartë nuk rishqyrtohen.".

Neni 31

Në nenin 610 pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

"Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.".

Neni 32
**Dispozitë kalimtare**

1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.".

Neni 33
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 45/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8577, DATË 10.2.2000, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7/b, pika 3, fjalia "Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit." shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 7/c, pika 4, fjalia "Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit." shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 18, pika 3, pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.".

Neni 4

Në nenin 86, pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"Deri në emërimin e të paktën tre të katërtave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, por, në çdo rast, jo më vonë se data 31.12.2023, mbledhja e posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas pikës 3 të nenit 7/ç të këtij ligji, është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 46/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 98/2016, "PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, shkronja "e", ndryshohet si më poshtë:

"e) "Ndihmës ligjor" është ndihmësi që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit.".

Neni 2

Në nenin 17, pika 5, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.".

Neni 3

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

"Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe gjykata e posaçme, për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë dhe të apelit, gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ose me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, sipas parashikimeve të ligjeve procedurale, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.".

Neni 4

Në nenin 26 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 3, pas togfjalëshit "mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve" shtohet togfjalëshi "ndërmjet gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë".

2. Në pikën 4, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

"Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve që ushtrojnë detyrën në gjykatë.".

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

"5/1 Në rastet kur nuk konkurron asnjë nga gjyqtarët që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale, ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.".

Neni 5

Në nenin 29, pika 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në mbledhje marrin pjesë të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë detyrën. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gjyqtarëve.".

Neni 6

Në nenin 31 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kolegji Civil gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Në rastet e gjykimeve, për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Civil gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.".

2. Në pikën 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kolegji Penal gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Në rastet e gjykimeve, për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Penal gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.".

3. Në pikën 3, fjalia e fundit shfuqizohet.

4. Në pikën 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

"Kolegji Administrativ gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.".

5. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

"5. Trupi gjykues kryesohet nga kryetari i kolegjit dhe në mungesë të tij nga gjyqtari relator. Në rastin kur në trup gjykues është kryetari i gjykatës, ai kryesohet nga ky i fundit.".

Neni 7

Në nenin 32, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

"2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi.".

Neni 8

Në nenin 34, pika 6, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "b" numri "10" zëvendësohet me numrin "5".

2. Shkronja "e" shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 42 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet në "Ndihmësit ligjorë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.".

3. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1 Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, pasi ka vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 15, pika 3, shkronja "b", të këtij ligji, llojin dhe natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, si dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Gjykatës, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.".

4. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

"10. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kushtet dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin ndihmësit ligjorë në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, llojin dhe natyrën e detyrave të ndihmësve ligjorë, llojin dhe natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, për kriteret dhe procedurat për ndarjen e çështjeve me short, si dhe vlerëson rregullisht ngarkesën e punës së ndihmësve ligjorë dhe siguron një numër të përshtatshëm të tyre për çdo gjykatë.".

Neni 10

Në nenin 50, shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit;".

Neni 11

Në nenin 53 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) të verifikojë plotësimin nga kandidatët të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, si dhe të pasurisë dhe figurës;".

2. Në pikën 9, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve ndiqen të njëjtat rregulla, si dhe për kandidatët për formimin fillestar, për magjistratë, sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".".

Neni 12

Në nenin 56 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 pas togfjalëshit "Për pozicionin e ndihmësit ligjor në" shtohet togfjalëshi "gjykatat e shkallës së parë dhe".

2. Në pikën 2, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndër-kombëtare.".

Neni 13

Në nenin 64, pika 10 shfuqizohet.

Neni 14

Pas nenit 83, shtohet neni 83/1 më këtë përmbajtje:

"Neni 83/1

**Përvoja profesionale e zëvendëskryetarit të gjykatës**

Përjashtimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.".

Neni 15

Në nenin 85, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1 Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e

nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.".

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 47/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR"**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8, pika 1, togfjalëshi "por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës" shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 20/1

1. Me qëllim funksionimin normal të bërthamës komanduese elektronike në Prokurorinë e Posaçme caktohen specialistë të fushës, të cilët gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

2. Paga e specialistit të bërthamës komanduese elektronike është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1 të këtij ligji.

3. Specialistët e bërthamës komanduese elektronike përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1 të këtij ligji.".

Neni 3

Në nenin 21 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 3 pas togfjalëshit "Punonjësit e këtij sektori" shtohet togfjalëshi "gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe".

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"4. Paga e punonjësve të këtij sektori është e njëjtë me pagën e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 39/1 të këtij ligji.

5. Punonjësit e këtij sektori përfitojnë të njëjtin trajtim si punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas përcaktimit të nenit 40/1 të këtij ligji.".

Neni 4

Pas nenit 35 shtohet neni 35/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 35/1
**Paga e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Paga e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me pagën bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të

legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesë për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.".

Neni 5

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 36/1
**Paga e zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Paga e zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me 80 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme."

Neni 6

Pas nenit 38 shtohet nenit 38/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 38/1
**Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Paga e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 70 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.".

Neni 7

Pas nenit 39 shtohet nenit 39/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 39/1
**Paga e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore**

1. Paga e oficerit nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga paga bazë, shtesa për vjetërsi dhe shtesa për vështirësi pune.

2. Paga bazë është e barabartë me 60 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme, sipas legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 për qind të pagës referuese bazë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për çdo vit shërbimi në funksion, por jo më shumë se 25 vjet shërbim.

4. Shtesa për vështirësi pune llogaritet në masën 50 për qind të pagës bruto fillestare të prokurorit pranë Prokurorisë së Posaçme.".

Neni 8

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 40/1
**Trajtimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfitojnë të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.

2. Trajtimi i punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin të drejtën e pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera të pagueshme, lejen pa të drejtë page, trajtimin financiar gjatë qëndrimit në punë, të drejtën për sigurim shëndetësor të veçantë, të drejtën për përfitim të kredisë me interesa të buta, kompensimin për strehim, sigurimin e jetës, mbrojtjen e veçantë, si dhe trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbasin jetën për shkak të detyrës.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat, procedurat dhe kriteret për trajtimin e punonjësve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, me të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.".

Neni 9

Në nenin 44, pika 2, pas togfjalëshit "pranë Prokurorisë së Posaçme" shtohet togfjalëshi "dhe punonjësit e administratës së Byrosë Kombëtare të Hetimit".

Neni 10

Pas nenit 44 shtohet neni 44/1 me këtë përmbajtje

Neni 44/1
**Shpërblimi për vështirësi pune**

1. Nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar përfiton shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse.

2. Nëpunësi civil në prokurorinë e posaçme dhe në Byronë Kombëtare të Hetimit përfiton shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse. Kanë të drejtë të përfitojnë shtesë për vështirësi pune në masën 50 për qind të pagës përkatëse edhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Neni 11
**Dispozitë kalimtare**

Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, punonjësit e sektorit të hetimit financiar, si dhe punonjësit e bërthamës komanduese elektronike përfitojnë pagën, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nga data e emërimit të tyre në detyrë.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 48/2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 25/2019, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE"**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 30 pika 4 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 49/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 49/2012, "PËR GJYKATAT ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 12 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.".

Neni 2

Në nenin 43 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, pas përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, publikohet i plotë në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit.".

Neni 3

Në nenin 48 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Relatori i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, kur çmon se të metat e ankimit nuk janë konstatuar nga gjyqtari i vetëm sipas nenit 46 të këtij ligji, me vendim njofton palën për të plotësuar të metat brenda 5 ditëve, duke e informuar për pasojat ligjore në rastin e mosplotësimit të të metave të ankimit brenda afatit të caktuar. Kur të metat e ankimit nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, relatori, në dhomë këshillimi, vendos kthimin e ankimit. Kundër vendimit të relatorit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit për kthimin e ankimit lejohet rekurs i veçantë.".

Neni 4

Pas nenit 56 shtohet neni 56/a me këtë përmbajtje:

"Neni 56/a
**Përmbajtja e rekursit**

1. Rekursi duhet të përmbajë:
a) palët ndërgjyqëse;
b) vendimin që kundërshtohet;
c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;
ç) shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 58 të këtij ligji;
d) prokurën e avokatit që përfaqëson palën.
2. Rekursi mund të paraqitet në përputhje me formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Gjykatës së Lartë."

Neni 5

Në nenin 57 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
1. Në pikën 1 shkronja "b" shfuqizohet.
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Në rast se rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe kur ai nuk është nënshkruar ose nuk është paraqitur në përputhje me nenin 56/a të këtij ligji, gjyqtari i vetëm ose relatori që ka dhënë vendimin njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve. Shqyrtimi i rekursit sipas këtij neni bëhet në dhomë këshillimi.".
3. Në pikën 3 fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
"Kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e rekursit mund të bëhet rekurs i veçantë.".

Neni 6

Në nenin 60 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Gjykata administrative, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, dërgon rekursin së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit ose relatorit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundërrekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Kur të metat e rekursit nuk janë konstatuar nga gjykata më e ulët, relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë me vendim njofton palën për të plotësuar të metat brenda 5 ditëve. Kur të metat e rekursit nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, relatori, në dhomë këshillimi, vendos kthimin e rekursit. Kundër vendimit të relatorit të çështjes në Gjykatën e Lartë për kthimin e rekursit nuk lejohet ankim.".

3. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Ky afat është 45 ditë kur rekursi është paraqitur ndaj një vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me gjykimin e aktit nënligjor normativ.".

Neni 7

Neni 60/1 shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 61, pika 2, numri "21" zëvendësohet me numrin "15".

Neni 9

Në nenin 62, pika 1, shkronjat "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"b) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

c) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Administrativ thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, në rastet e përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" të nenit 58 të këtij ligji.".

Neni 10

Pas nenit 62 shtohet neni 62/a me këtë përmbajtje:

"Neni 62/a

**Njësimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore**

1. Kolegji Administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Administrativ për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar dhe publikohet menjëherë pas arsyetimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Administrativ me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, në të cilën marrin pjesë trupa gjyqësore që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosin ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si

dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim, cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i shkurtër se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Administrativ dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.".

Neni 11

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 63
**Vendimet e Gjykatës së Lartë**

1. Pas shqyrtimit të çështjes Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji;

b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga Gjykata Administrative e Apelit;

d) prishjen e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit e të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;

dh) ndryshimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe zgjidhjen e çështjes në themel kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast, vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 12
**Dispozitë kalimtare**

1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**LIGJ**
**Nr. 50/2021**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, "PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 11, pika 3, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) kompensim për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm ose për caktimin e përkohshëm;".

Neni 2

Në nenin 12, pika 5, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me vlerën e elementit "shtesa për pozicion" të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. "Shtesa për pozicion" është elementi bazë i pagës mujore të nëpunësve civilë, nëpërmjet së cilës caktohet vlera e çdo vendi pune në shërbimin civil, pa u diktuar nga ndryshimet e pagës që shkaktohen nga rrethanat e posaçme ose individuale të vetë nëpunësit civil si vjetërsia apo shtesa për kushte pune. Për qëllimet e caktimit të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, "shtesa për pozicion" është i njëjti element i pagës si edhe elementi "paga bazë e kategorisë", sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, apo me çdo lloj emërtimi tjetër që cakton elementin bazë të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me vlerën e elementit "shtesa për pozicion" ose "paga bazë e kategorisë" sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.".

2. Në shkronjën "d" togfjalëshi "60 për qind të pagës bruto fillestare" zëvendësohet me togfjalëshin "80 për qind të pagës bruto fillestare".

Neni 3

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 13/1
**Paga e magjistratëve në skemë delegimi**

1. Magjistrati në skemë delegimi përfiton 10 për qind shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij.

2. Magjistrati në skemë delegimi, që përmbush kriteret për t'u ngritur në detyrë në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme, si dhe përmbush kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, sipas pikës 3 të nenit 47 të këtij ligji, gjatë periudhës së delegimit në këto institucione përfiton shtesën për vështirësi pune sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji. Në rastet kur magjistrati delegohet për çështje të veçanta, ai përfiton shtesë të reduktuar për vështirësi pune, por jo më shumë se gjysma e shtesës sipas shkronjës "d" të pikës 5 të nenit 12 të këtij ligji.

Këshillat, pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse të financave, përcaktojnë rregulla të detajuara për masën e shtesës së reduktuar për vështirësi pune dhe mënyrën e llogaritjes së saj duke u bazuar në llojin, natyrën, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e çështjeve për të cilat delegohen.

Neni 4

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
**Kompensimi i magjistratëve**

1. Magjistrati në skemën e delegimit i caktuar në një gjykatë ose prokurori, si dhe magjistratët e tjerë, kur transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht për jo më shumë se 22 ditë pune, përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe

dietë ditore për çdo ditë të ushtrimit të funksionit pranë gjykatës ose prokurorisë ku delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht. Shpenzimet e transportit llogariten në bazë të distancës më të shkurtër që rezulton ndërmjet gjykatës ose prokurorisë ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose me vendbanimin e tij të përhershëm.

2. Magjistrati në skemën e delegimit, magjistrati i transferuar përkohësisht ose magjistrati i caktuar përkohësisht, kur delegohet, transferohet përkohësisht ose caktohet përkohësisht për një periudhë kohore më të gjatë se periudha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfiton një kompensim mujor në masën e jo më shumë se 80 për qind të pagës referuese bazë. Ky kompensim mbulon çdo shpenzim për qëndrimin dhe transportin e magjistratit në gjykatën ose prokurorinë ku magjistrati është deleguar, transferuar përkohësisht ose caktuar përkohësisht.

3. Magjistrati nuk përfiton kompensimet sipas këtij neni në rastet kur gjykata ose prokuroria ku ai delegohet, transferohet ose caktohet përkohësisht ndodhet në të njëjtin territor me gjykatën ose prokurorinë ku ai është i caktuar në mënyrë të përhershme në pozicion ose në territorin e vendbanimit të tij të përhershëm.

4. Rregulla të detajuara për mënyrën e caktimit të kompensimit dhe masës së tij sipas këtij neni, përcaktohen nga Këshillat pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat.".

Neni 5

Në nenin 22, pika 1, shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) vlerësohet i pamjaftueshëm ose jepet masa disiplinore e uljes së përkohshme të pagës, sipas parashikimeve të këtij ligji;".

Neni 6

Në nenin 27 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 shkronja "c" shfuqizohet.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

"1/1. Magjistrati gëzon të drejtën e pensionit të parakohshëm edhe në rast se Këshilli vendos mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të pamundësisë fizike dhe mendore sipas nenit 67 të këtij ligji.

1/2. Pensioni i parakohshëm është një pension pleqërie i reduktuar dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 64 të këtij ligji, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë për magjistratët që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 1/1 të këtij neni është 0.6 për qind në muaj.".

Neni 7

Në nenin 28 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;".

2. Në shkronjën "ç" pas togfjalëshit "me kohë të plotë" shtohet togfjalëshi "pas përfundimit të studimeve të integruara në drejtësi sipas shkronjës "c" të këtij neni,".

3. Shkronja "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal;".

4. Shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore,

pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;".

Neni 8

Në nenin 32 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31 të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.".

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

4. Në çdo rast Këshillat çmojnë, sipas bindjes së tyre, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në vlerësimin e hollësishëm të raporteve të paraqitura nga institucionet kompetente, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;

c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.".

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë."

5. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"6/1. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor rishikon vendimin në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.".

Neni 9

Në nenin 34 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

"Verifikimi i pasurisë dhe figurës dhe renditja e kandidatëve magjistratë të diplomuar".

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Çdo vit, jo më vonë se në fund të muajit janar, Shkolla e Magjistraturës u dërgon Këshillave listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Çdo vit, deri në fund të muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magjistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti.".

Neni 10

Në nenin 35 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të

kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Në pikën 4 shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:

“a) emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, ose refuzojnë të emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, por që nuk përmbush kriteret e emërimit;

b) lejojnë kandidatin që përmbush kriteret e emërimit për t’u emëruar në vitin pasardhës, pas paraqitjes së kërkesës sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 11

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36
**Riemërimi magjistrat i ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve**

1. Ish-gjyqtarët dhe ish-prokurorët mund të kandidojnë për t’u riemëruar si magjistratë jo më vonë se dy javë pas shpalljes së vendeve të lira, sipas pikës 1 të nenit 39 të këtij ligji.

2. Këshillat shqyrtojnë kërkesat për t’u riemëruar në rast se numri i vendeve të lira është më i madh se numri i të diplomuarve që përmbushin kriteret e emërimit sipas nenit 35 të këtij ligji.

3. Këshillat mund të riemërojnë magjistratë, brenda numrit të vendeve të lira, kandidatët që:

a) përmbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f” të nenit 28 të këtij ligji;

b) kanë ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit;

c) nuk kanë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit, përpara kërkesës për riemërim si magjistrat.

ç) kalojnë me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës, sipas rregullave të caktuara në nenin 32 të këtij ligji.

4. Këshillat vendosin të refuzojnë riemërimin kur kandidati nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve që mund të riemërohen si magjistratë në rastet kur numri i vendeve të lira është më i vogël se numri i kandidatëve që kanë kandiduar për t’u riemëruar dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.”.

Neni 12

Në nenin 39 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Jo më vonë se dy javë nga shpallja e vendeve të lira, të emëruarit i bëjnë me dije Këshillit, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata ose prokurori në të cilat kërkojnë të caktohen.”.

2. Në pikën 3 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të emëruarit, sipas pikës 1 të këtij neni, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni.”

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pas caktimit në pozicion të të emëruarve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni, Këshillat shpallin vendet e lira për caktimin në pozicion të magjistratëve të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji.”

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Caktimi në pozicion i të riemëruarve sipas nenit 36 të këtij ligji bazohet:

a) së pari, në rezultatet e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 49 të këtij ligji;

b) së dyti, në rastin kur ka barazi në aftësitë profesionale, mbizotëron kriteri i përvojës profesionale, duke iu referuar viteve të përvojës në sistemin gjyqësor ose prokurorisë;

c) së treti, duke përmbushur preferencat në tri gjykata ose prokurori të deklaruara nga të riemëruarit, në respektim të përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, për aq sa gjejnë zbatim.”.

Neni 13

Në nenin 43 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 shkronja “b” shfuqizohet.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.".

3. Në pikën 7, shkronja "a", nënparagrafi "i" ndryshohet si më poshtë:

"i) që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, si anëtar i Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar, do të ketë përparësi;".

4. Në pikën 8, shkronja "a", hiqet togfjalëshi "sipas pikës 6 të këtij neni".

5. Në pikën 12 shkronjat "a" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;".

Neni 14

Në nenin 45 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 1 fjala "komanduar" zëvendësohet me fjalën "caktuar".

2. Në pikën 4 shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori, për të cilën magjistrati përmbush kërkesat. Në rastet kur caktohet për hetimin ose gjykimin e një ose disa çështjeve të veçanta në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ose Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të përmbushë kriteret, si dhe të japë pëlqimin sipas nenit 47 të këtij ligji. Delegimi për një çështje të veçantë kryhet kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.".

3. Në pikën 6 pas togfjalëshit "t'i kërkojë Këshillit cakimin" shtohet togfjalëshi, "Për një çështje ose".

Neni 15

Në nenin 47, pika 2, shkronja "b", pas togfjalëshit "ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" shtohet togfjalëshi "duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar".

Neni 16

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.".

2. Në pikën 14 shkronjat "a" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional;

c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta;".

Neni 17

Në nenin 53 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 pas togfjalëshit "brenda sistemit të drejtësisë" shtohet togfjalëshi "ose organizatë ndërkombëtare".

2. Në pikën 2 pas togfjalëshit "dhe përafrimit të legjislacionit" shtohet togfjalëshi "si dhe organizatat ndërkombëtare.".

3. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

"8/1. Magjistrati që komandohet në një organizatë ndërkombëtare, me qëllim përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në atë organizatë, gëzon të njëjtin status me diplomatët, sipas parashikimeve

të ligjit në fuqi për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.".

Neni 18

Në nenin 64 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;".

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.".

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës. Mbarimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit të Prokurorisë së Posaçme deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.".

Neni 19

Pas nenit 170 shtohet neni 170/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 170/1
**Caktimi i magjistratëve për çështje të veçanta**

1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm dhe transferimi i përkohshëm i magjistratëve është i padobishëm për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, Këshillat mund të caktojnë një magjistrat për gjykimin ose hetimin e çështjeve të veçanta në një gjykatë ose prokurori të ndryshme nga ajo ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ka një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh ose prokurorësh në një gjykatë ose prokurori; ose

b) kur gjyqtarët ose prokurorët e një gjykate ose prokurorie janë ligjërisht të padisponueshëm për gjykimin ose hetimin e një apo disa çështjeve.

2. Magjistrati që caktohet për një çështje të veçantë përfiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit, shpenzimeve të transportit, si dhe dietë ditore në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji.

3. Këshillat përcaktojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për caktimin e magjistratëve për çështje të veçanta.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë për çështje të veçanta sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.".

Neni 20

Pas nenit 170/1 shtohet neni 170/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 170/2
**Caktimi i përkohshëm në pozicione të lira të përkohshme**

1. Kur numri i të emëruarve të sapodiplomuar është më i madh se vendet e lira të shpallura për ata, të emëruarit që nuk janë caktuar në një pozicion të lirë të përhershëm për magjistrat caktohen përkohësisht në një pozicion të lirë të përkohshëm.

2. Këshillat shpallin pozicionet e lira të përkohshme për të emëruarit e sapodiplomuar brenda një jave nga përfundimi i caktimit të të emëruarve në pozicionet e lira të përhershme.

3. Në rastet e caktimit të përkohshëm në një pozicion magjistrati:

a) Këshillat i ofrojnë të emëruarit mundësinë e zgjedhjes për të paktën dy pozicione, sipas radhës së renditjes së tyre në listën e të diplomuarve;

b) i emëruari i caktuar përkohësisht në një pozicion magjistrati duhet të marrë pjesë në procedurën e radhës së lëvizjes paralele në shkallën e parë, me qëllim që të caktohet sa më shpejt në një pozicion të lirë të përhershëm.

4. Këshillat nuk mund të caktojnë magjistratë përkohësisht në pozicione të lira të përkohshme,

sipas këtij neni, pas përfundimit të afatit të caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve.”.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.3.2021.

**VENDIM**
**Nr. 34/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 017, DATË 12.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 46/2021, ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 98/2016, ‘PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’’”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 017, datë 12.4.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 46/2021, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, ‘Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë’’”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 35/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 035, DATË 16.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 43/2021, ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, ‘KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR’”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 035, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 43/2021, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar’”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 36/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 036, DATË 16.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 47/2021, ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 95/2016, ‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR’’”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 036, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 47/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, 'Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 37/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 037, DATË 19.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 48/2021, 'PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 25/2019, 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE""**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 037, datë 19.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 48/2021, 'Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019, 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore"".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 38/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 033, DATË 16.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 49/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 49/2012, 'PËR GJYKATAT ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE', TË NDRYSHUAR"'**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I.Rrëzimin e dekretit nr. 13 033, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 49/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, 'Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative', të ndryshuar"'.

II.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 39/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 034, DATË 16.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 42/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2016, 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË""**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 034, datë 16.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 42/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 40/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 031, DATË 15.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 41/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995, 'KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË', I NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 031, datë 15.4.2021, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 41/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar"'.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 41/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 032, DATË 15.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 44/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, 'KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË', TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 032, datë 15.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 44/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar"'.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 42/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 023, DATË 14.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 45/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8577, DATË 10.2.2000, 'PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE', TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 023, datë 14.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 45/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshme në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, 'Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese', të ndryshuar"'.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 43/2021**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13 038, DATË 19.4.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 50/2021, 'PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, 'PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË', TË NDRYSHUAR"'**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 038, datë 19.4.2021, të Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr. 50/2021, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"'.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 44/2021**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT DHE PROPOZIMIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT "PËR NGRITJEN E NJË KOMISIONI HETIMOR, BAZUAR NË KËRKESËN E NJË GRUPI DEPUTETËSH, PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS"**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në kërkesën e 49 deputetëve, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut "Për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 46/2021**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS MILENA SELIMI ANËTARE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Milena Selimi zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 47/2021**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT THANAS GOGA ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Thanas Goga zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 48/2021**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT GËZIM PODGORICA ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Gëzim Podgorica zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

**VENDIM**
**Nr. 49/2021**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ENGJËLL NDOCAJ ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Engjëll Ndocaj zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 7.5.2021.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 71
Datë: 2021/05/14 14:05:25
65369931-415b-4eef-892a-b985b2e1882a

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë